



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOORDINATOR PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË
NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT
GRUPI TEMATIK ANTIKORRUPSION

Nr. 276 prot.

Tiranë, më 19.01.2022

VENDIM

Nr. 1, datë 19.01.2022

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË MONITORIMIT, KORRIK-SHTATOR 2021,
NË ZBATIM TË STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE KUNDËR
KORRUPSIONIT 2015-2023

Në mbështetje të vendimit nr.516, datë 01.07.2020, të Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.247, datë 20.03.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit për periudhën 2015-2020", dhe miratimin e Planit të Veprimit 2020 – 2023, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2015-2023, e të Pasaportës së Indikatorëve", të urdhërit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nr.132, datë 08.03.2020 "Për mbylljen e aktiviteteve publike dhe jo publike dhe anulimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura" i ndryshuar, Grupi Tematik Antikorrupsion/Komiteti Koordinator

VENDOSI:

1. Miratimin e Raportit të Monitorimit, korrik - shtator 2021, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2023, në mbledhjen e zhvilluar *online*, nëpërmjet platformës zoom, datë 19.01.2021, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë të publikojë Raportin e Monitorimit, korrik - shtator 2021, në faqen zyrtare të saj.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Ministri i Drejtësisë

Ulsi Manja





KOORDINATORI KOMBËTAR KUNDËR KORRUPSIONIT

RAPORT

MONITORIMI PËR PERIUJDHËN KORRIK-SHTATOR 2021

STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT 2015 – 2023

www.drejtesia.gov.al

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE	5
- <i>Përmbledhje ekzekutive mbi progresin e zbatimit të planit të veprimit për korrik-shtator 2021.....</i>	6
- <i>Realizimi i rekomandimeve të lëna për zbatim në raportin gjashtëmuor 2021.....</i>	10
- <i>Metodologjia e hartimit të raportit të monitorimit</i>	12
- <i>Matrica e riskut.....</i>	15
- <i>Konsultimi publik</i>	15
PROGRESI I STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT.....	16
- <i>Masa dhe aktivitete të implementuara me sukses në periudhën përkatëse.....</i>	16
- <i>Statusi i masave dhe aktiviteteve që kanë realizuar qëllimet e politikave (Qasjet).....</i>	19
- <i>Statusi i aktiviteteve që kanë realizuar qëllimet e politikave (Qasjet).....</i>	20
- <i>Statusi i masave që kanë realizuar qëllimet e politikave (Qasjet).....</i>	21
- <i>Vlerësimi i arritjeve kryesore duke përdorur masat dhe aktivitetet</i>	22
- <i>Histori suksesi (përmes masave priritare)</i>	23
EKZEKUTIMI I BUXHETIT	24
KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	25
- <i>Rekomandime</i>	26
- <i>Vlerësimi i sfidave, boshllëqeve dhe joefikasitetit</i>	27
- <i>Vlerësimi i riskut duke përdorur masat dhe aktivitetet</i>	28
- <i>Hapat e rradhës.....</i>	28
ANEKS	

LISTA E SHKURTIMEVE

AAPSK	Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara
ADB	Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
AKU	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
AMSHC	Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile
AMVV	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore
APP	Agjencia e Prokurimit Publik
ASHSGJ	Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor
ATP	Agjencia e Trajtimit të Pronave
AZHBR	Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural
BKH	Byroja Kombëtare e Hetimit
DNJF	Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas
DPB	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
DPP	Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit
DPPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
DPSHP	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës
DVP	Drejtoria Vendore e Policisë
GTA	Grupi Tematik për Antikorrupsionin
ILDKPKI	Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave
IML	Instituti i Mjeksisë Ligjore
KDIMDP	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
KKK	Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KSHB	Komiteti Shqiptar i Birësimit
KSHZ	Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve
MASR	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
MB	Ministria e Brendshme
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MD	Ministria e Drejtësisë
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MK	Ministria e Kulturës
MM	Ministria e Mbrojtjes
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
PP	Prokuroria e Përgjithshme
PV	Plani i Veprimit
QBZ	Qendra e Botimeve Zyrtare
SNKK	Strategjia Ndërsektorale kundër Korrupsionit
SPAK	Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar
SHÇBA	Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat
SHKBB	Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

HYRJE

Korrupsioni është një kërcënim për demokracinë, mirëqeverisjen, konkurrencën e ndershme, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, shoqëror dhe politik të një vendi. Ai pengon rëndë zhvillimin ekonomik, duke krijuar një sistem pabarazie, paragjykimi e nepotizmi, duke shkatërruar besimin e njerëzve tek shteti i tyre, prandaj lufta kundër korrupsionit është sot një nga sfidat parësore të çdo shteti me kulturë demokratike, vizion dhe integritet të lartë. Qeveria ka dhe do vazhdojë në mënyrë të pandalur të ketë një vullnet të palëkundur në luftën kundër korrupsionit, përmes aksioneve parandaluese, masave ndëshkuese dhe aktiviteteve ndërgjegjëse.

Përparësia e qeverisë në fushën e luftës kundër korrupsionit, përkon më së miri me kushtëzimet e vendosura nga Bashkimi Evropian për hapjen e negociatave për anëtarësimin në BE. Lufta kundër korrupsionit është një ndër pesë politikatat të cilat vendi ynë këshillohet t'i ndjekë me përparësi në procesin e integritet evropian të vendit. Po kështu, parandalimi dhe ndëshkimi i korrupsionit është një detyrim që rrjedh nga aderimi i Shqipërisë në instrumentat ndërkombëtarë për luftën kundër korrupsionit si Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, Konventa Penale e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit, Konventa Civile e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit, etj.

Prej vitit 2015 Shqipëria ndjek dhe zbaton Strategjinë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit. Me Vendimin Nr.516, datë 01.07.2020 të Këshillit të Ministrave afati i zbatimit të SNKK u zgjat deri në vitin 2023. Vizioni i SNKK-së 2015-2023 është: *“Institucione shqiptare transparente dhe me integritet të lartë, që gëzojnë besimin e qytetarëve dhe garantojnë shërbim cilësor dhe të pakorruptueshëm”*. Qëllimet madhore politikës së Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit janë parandalimi, ndëshkimi dhe ndërgjegjësimi/edukimi rreth korrupsionit. Këto qëllime politikash (qasje) janë afatgjata dhe shtrihen përgjatë kohës së zbatimit të strategjisë dhe planit të veprimit.

Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, 2015-2023, përmban 18 objektiva specifike, të cilët janë:

Parandalim:

A.1 Rritja e transparencës në Veprimtarinë Shtetërore dhe përmirësimi i aksesit të qytetarëve në informacion

A.2 Rritja e transparencës në planifikim, menaxhim dhe kontrollin e fondeve publike

A.3 Fuqizimi i infrastrukturës elektronike të institucioneve publike

A.4 Përmirësimi i trajtimit të denoncimeve ndaj korrupsionit

A.5 Forcimi i regjimit të deklarimit dhe kontrollit të pasurive të zyrtarëve publikë dhe rasteve të konfliktit të interesave

A.6 Forcimi i regjimit të kontrolleve mbi financimin e partive politike

A.7 Përmirësimi i efikasitetit të auditimit dhe inspektimit të brendshëm dhe përdorimi sistematik i analizave të riskut

A.8 Përdorimi sistematik i mekanizmit të evidentimit të hapësirave për korrupsion

A.9 Forcimi i integritetit të nëpunësve publikë

A.10 Analizimi i prirjeve të korrupsionit, i efektivitetit të masave antikorrupsion dhe përmirësimi i statistikave në lidhje me veprimtarinë e agjencive ligjzbatuese kundër korrupsionit

A.11 Adoptimi i politikave anti-korrupsion në nivelin e qeverisjes vendore

Ndëshkim:

B.1 Përmirësimi i efikasitetit dhe efektivitetit të hetimeve penale kundër korrupsionit

B.2 Përmirësimi i bashkëpunimit midis institucioneve ligjzbatuese në ndjekjen penale dhe ndëshkimin penal të korrupsionit

B.3. Rishikimi i kuadrit ligjor për ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe financiar

B.4. Përmirësimi i bashkëpunimit gjyqësor dhe policor ndërkombëtar në luftën kundër korrupsionit.

Ndërgjegjësim:

C.1 Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi pasojat e korrupsionit

C.2 Nxitja e publikut për të përdorur aktivisht mekanizmat për denoncimin e korrupsionit

C.3. Inkurajimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile.

Përmbledhje ekzekutive mbi progresin e zbatimit të planit të veprimit për korrik- shtator 2021

Plani i Veprimit 2020-2023, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, 2015-2023, parashikon masa dhe aktivitete specifike që duhen të realizohen për përmbushjen e këtyre objektivave, sipas afateve të detajuara në të.

Ky raport monitorimi, *korrik – shtator 2021*, paraqet vetëm realizimin e masave dhe aktiviteteve (produkteve) të Planit të Veprimit. Raporti identifikon progresin dhe ecurinë e zbatimit të masave për këtë periudhë monitorimi, duke marrë në konsideratë dhe vlerësim realizimin e tyre, shkallën e performancës së aktiviteteve të institucioneve që raportojnë aktiviteteve dhe masa në proces zbatimi dhe uljen e numrit të masave të pazbatuara.

Raporti identifikon arritjen e rekomandimeve dhe hapat për zbatimin e tyre, referuar rekomandimeve të lëna në raportin gjashtë-mujor të monitorimit 2021. Në këtë analizë ofrohet gjithashtu informacioni për të parë relevancën e përmbajtjes së këtij plani veprimi përkundrejt arritjes së indikatorëve të parashikuar në Pasaportën e Indikatorëve, të objektivëve specifikë dhe të qëllimit madhor, atë të arritjes së qëllimeve të politikave (qasjeve) të Strategjisë, parandalim – ndëshkim – ndërgjegjësim.

Ky raport krijon dhe vendos të gjithë infrastrukturën analitike që rekomandimet e lëna të trajtohen në raportet pasardhëse.

Për këtë periudhë monitorimi, *korrik – shtator 2021*, janë mbledhur dhe analizuar të dhëna për 59 masa e 107 aktivitete, të shpërndara përkatësisht në 30 masa e 57 aktivitete për qasjen parandaluese (A), 20 masa e 29 aktivitete për qasjen ndëshkuese (B) dhe 9 masa e 21 aktivitete për qasjen ndërgjegjësuere (C).

Përmes zbatimit të Planit të Veprimit për periudhën *korrik – shtator 2021*, janë realizuar plotësisht 29 masa, pjesërisht 22 masa dhe nuk janë realizuar 8 masa si dhe janë realizuar plotësisht 65 aktivitete, pjesërisht 21 aktivitete dhe të përealizuara janë 21 aktivitete.

Në vijim paraqitet realizueshmëria e objektivëve të strategjisë sipas shkallës së realizimit të masave dhe aktiviteteve:

Objektivat		Shkalla e realizimit sipas masave
Parandalimi	A.1 Rritja e transparencës në Veprimtarinë Shtetërore dhe përmirësimi i aksesit të qytetarëve në informacion	51 në 85 për qind e masave të zbatuara
	A.2 Rritja e transparencës në planifikim, menaxhim dhe kontrollin e fondeve publike	51 në 85 për qind e masave të zbatuara
	A.3 Fuqizimi i infrastrukturës elektronike të institucioneve publike	86 në 110 për qind e masave të realizuara
	A.4 Përmirësimi i trajtimit të denoncimeve ndaj korrupsionit	Nga 51 në 85 për qind e masave të realizuara
	A.5 Forcimi i regjimit të deklarimit dhe kontrollit të pasurive të zyrtarëve publikë dhe rasteve të konfliktit të interesave	86 në 110 për qind e masave të realizuara
	A.6 Forcimi i regjimit të kontrolleve mbi financimin e partive politike	51 në 85 për qind e masave të realizuara
	A.7 Përmirësimi i efikasitetit të auditimit dhe inspektimit të brendshëm dhe përdorimi sistematik i analizave të riskut	86 në 110 për qind e masave të realizuara
	A.8 Përdorimi sistematik i mekanizmit të evidentimit të hapësirave për korrupsion	51 në 85 për qind e masave të realizuara

	A.9 Forcimi i integritetit të nëpunësve publikë	51 në 85 për qind e masave të realizuara
	A.10 Analizimi i prirjeve të korrupsionit, i efektivitetit të masave antikorrupsion dhe përmirësimi i statistikave në lidhje me veprimtarinë e agjencive ligjzbatuese kundër korrupsionit	86 në 110 për qind e masave të realizuara
	A.11 Adaptimi i politikave anti-korrupsion në nivelin e qeverisjes vendore	31 në 50 për qind e masave të realizuara
Ndëshkimi	B.1 Përmirësimi i efikasitetit dhe efektivitetit të hetimeve penale kundër korrupsionit	51 në 85 për qind e masave të realizuara
	B.2 Përmirësimi i bashkëpunimit midis institucioneve ligjzbatuese në ndjekjen penale dhe ndërshkrimin penal të korrupsionit	31 në 50 për qind e masave të realizuara
	B.3. Rishikimi i kuadrit ligjor për ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe financiar	31 në 50 për qind e masave të realizuara
	B.4. Përmirësimi i bashkëpunimit gjyqësor dhe policor ndërkombëtar në luftën kundër korrupsionit	31 në 50 për qind e masave të realizuara
Ndërgjegjësimi	C.1 Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi pasojat e korrupsionit	51 në 85 për qind e masave të realizuara
	C.2 Nxitja e publikut për të përdorur aktivisht mekanizmat për denoncimin e korrupsionit	51 në 85 për qind e masave të realizuara
	C.3. Inkurajimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile.	0 deri në 30 për qind e masave të realizuara

Për këtë periudhë *korrik – shtator 2021*, janë shënuar arritje në qëllimet e politikës (qasjen) parandaluese (A), ndëshkuese (B) dhe ndërgjegjësuere (C) të zbatimit të strategjisë, më konkretisht përmendim:

- KDIMDP ka rifilluar monitorimin e zbatimit të Programit të Transparencës në autoritetet e qeverisjes qendrore, 235 nga 317 autoritete publike dhe ka vijuar me monitorimin në autoritetet vendore, 46 nga 61 njësi të Vetëqeverisjes Vendore. Janë shtuar 5 autoritete të reja publike që kanë instaluar regjistrin elektronik të kërkesave dhe përgjigje, për periudhën raportuese korrik – shtator 2021. Totali i autoriteteve të reja publike për gjithë periudhën janar - shtator 2021, është 12.
- AKSHI vazhdon të rrisë shërbimet elektronike me një numër total prej 1209. Portali e-Albania u shërben 2 148 407 qytetarëve dhe 160 575 bizneseve, (2.3 milionë të regjistruar) pa kosto,

pa pritur në rradhë dhe, pa pasur asnjë kontakt fizik me punonjësit e administratës. Janë bërë 12.5 milionë aplikime për shërbime elektronike kryesisht në shërbimet e gjendjes civile, turizëm, kulturë dhe art, financa dhe ekonomi, shërbime sociale, arsim, punët e jashtme, etj. Për këtë periudhë raportimi, Drejtorja e Bashkëqeverisjes në Kryeministri ka raportuar 30 denoncime.

- ILDKPKI ka vazhduar procesin e koordinimit dhe mbështetjes me burimet e nevojshme institucionale, me qëllim finalizimin e angazhimeve të marra në kuadër të ngritjes së sistemit elektronik të deklarimit të interesave private në afatet e parashikuara, që është fundi i vitit 2021.
- KQZ ka vijuar me përditësimin e vazhdueshëm të metodologjisë së kontrollit dhe verifikimit të financave të partive politike. Janë publikuar raportet financiare të partive politike për vitin kalendarik 2020 dhe raportet financiare të partive politike për fushatën zgjedhore dhe rritja e kapaciteteve profesionale të kontrollit financiar, për verifikimin paraprak dhe kontrollin e raporteve financiare.
- MFE ka vijuar me realizimin e 19 vlerësimeve të jashtme të cilësisë në njësitë e auditit, që funksionojnë në njësitë publike; ka zhvilluar 2 takime me përfaqësues të drejtorive të auditit të brendshëm të institucioneve qendrore si dhe ka zhvilluar 4 trajnime me inspektorët financiarë publik mbi rastet e keqmenaxhimit, shpërdorimit të detyrës.
- Institucionet e varësisë së Ministrisë së Drejtësisë vazhdojnë procesin e vlerësimit të riskut të integritetit, në përputhje me dokumentin “Metodologjia e Vlerësimit të Riskut të Integritetit në Institucionet Qendrore” nën koordinimin e Ministrisë së Drejtësisë (1 takim i dedikuar në grup informuese/ndërgjegjësuere me përfaqësues e punonjës së varësive të MD);
- Janë zhvilluar operacione të hetimeve proaktive PSH-SHÇBA: Nga strukturat e hetimit të Shërbimit janë kryer 6 operacione për zbulimin, dokumentimin ligjor dhe goditjen e paligjshmërisë së punonjësve të policisë në format dhe fenomenet më shqetësuese, siç janë “korrupsioni pasiv”, “shpërdorimi i detyrës”, favorizimi i “kultivimit të bimëve narkotike” e “kontrabandës”, “ndihmës për kalim të paligjshëm të kufirit” etj. Këto operacione janë realizuar në bashkëpunim me SPAK, Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore të Shkallës së Parë dhe strukturave të Policisë së Shtetit, duke u finalizuar me dokumentimin me prova ligjore të veprimtarisë së kundërligjshme të 4 punonjësve të policisë dhe 10 shtetasve të implikuar, si dhe ekzekutimit të masave të sigurimit personal shtrëngues dhe ndalues të dhëna për ta si subjekte të procedimeve penale në ndjekje, nga Gjykata e Posaçme dhe ato të Rretheve Gjyqësore të Shkallës së Parë.
- Për grup veprat penale të korrupsionit në kompetencë të juridiksionit të përgjithshëm Prokuroria e Përgjithshme raporton se janë regjistruar 76 procedime me 66 të pandehur dhe 34 procedime me 38 të pandehur janë dërguar për gjykim ose krahasuar me 9 mujorin e vitit 2020, me rritje 3 herë të numrit të procedimeve të regjistruara dhe me rritje të numrit nga 2 në 34 të procedimeve dhe nga 15 në 38 të numrit të pandehurve të dërguar për gjykim për këto vepra penale.

- SPAK ka vijuar punën dhe për këtë periudhë numri i procedimeve të regjistruara gjithsej është 23 procedime me 15 persona në hetim; numri i procedimeve të dërguara për gjykim është 2 procedime me 12 të pandehur dhe numri i kërkesave të dërguara për pushim është 1 procedim me 2 të pandehur.
- Përgjatë kësaj periudhe raportuese, Ministria e Drejtësisë ka përmirësuar komunikimi dhe vizibilitetin publik për fushën nëpërmjet hartimit dhe publikimit të një buletin mujor elektronik me një përmbledhje aktivitetesh të zhvilluara përgjatë çdo muaji, e aksesueshme në faqen e Ministrisë së Drejtësisë dhe të shpërdarë via email në rrjetet e grupeve të ndryshme, akademia, biznese, partnerë të huaj të fushës, organizata të huaja, në gjuhën shqip dhe anglisht. Në kuadër të ndërgjegjësimit të publikut në përpjekjet kundër korrupsionit, Ministria e Drejtësisë në Rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit ka vijuar të promovojë dhe njohë me publikun e gjerë Rrjetin e Koordinatorëve Antikorrupsion për adresimin e ankesave të rasteve të dyshuara korruptive. Ministria e Drejtësisë ka vijuar bashkëpunimin me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Ambasadën e Italisë në Shqipëri për zbatimin konkret të marrëveshjes së bashkëpunimit, për promovimin e përbashkët të një projekti pilot didaktik-edukativ (moduli antikorrupsion) për mësuesit e arsimit të mesëm e të ulët.
- Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje raporton periodikisht mbi denoncimet e qytetarëve dhe bizneseve, çdo javë nëpërmjet të dhënave të detajuara të paraqitura në raport për çdo ministër dhe Kryeministrin; janë regjistruar 4448 çështje, kërkesa, ankesa, nga të cilat 2 699 i përkasin autoriteteve në nivel qendror, 943 në nivel vendor dhe 806 janë për çështje biznesi; janë dhënë 18 masa ndëshkimore nga hetimet administrative të institucioneve përgjegjëse për mosdhënien në kohë të së drejtës të qytetarëve.

Realizimi i rekomandimeve të lëna për zbatim në raportin gjashtë-mujor 2021

Për këtë periudhë *korrik – shtator 2021*, ka një ecuri dhe përmirësim në kryerjen e masave dhe aktiviteteve me qëllim plotësimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e mëparshëm të monitorimit (gjashtë-mujori i parë i vitit 2021), ku përmendim përkatësisht parashikimet e bëra për objektivet A1; A7; B1 dhe B2. Vijon të mbetet problematik moszbatimi i disa masave dhe aktiviteteve nën objektivin C3.

Krahasuar me të dhënat e raportit të monitorimit për periudhën raportuese (më të fundit), të janar - qershor 2021, vihet re në total një trend rritës në 12 objektiva, të cilat janë A.1, A.4, A.5, A.6, A.8, A.9, A.10, A.11, B.1, B.2, B.3, C.2 dhe një trend zbritës 5 objektive, konkretisht A.2, A.3, B.4, C1 e C.3.

Nga monitorimi dhe vlerësimi i kryer, rezulton se institucionet duhet të vijojnë të luajnë një rol proaktiv në arritjen e objektivave të vendosur në Planin e Veprimit 2020-2023, me qëllim realizimin e produkteve (output) që çojnë në arritjen e vlerave të synuara në treguesit e parashikuar për vitin 2021. Është poashtu e nevojshme që të intensifikohen përpjekjet në ato iniciativa që kanë

një impakt më të ndjeshëm në arritjen e treguesve, siç mund të përmenden masat nën objektivët A.11, B.2, B.3, B.4 dhe C3.

Sikurse është evidentuar më lart, për këtë periudhë raportimi, ka masa dhe aktivitete për të cilat mungon raportimi mbi zhvillimin e tyre nga institucionet zbatuese (1 masë dhe 2 aktivitete) dhe atë të buxhetit të përdorur (15 masa dhe 29 aktivitete).

Por, nga monitorimi dhe vlerësimi i kryer, rezulton se institucionet duhet të aktivizojnë rolin e tyre të zbatimit në përputhje me këtë plan veprimi, me qëllim realizimin e produkteve (output) që çojnë në arritjen e vlerave të synuara në treguesve të parashikuar për vitin 2021, pasi duhet të fillojnë, të vijojnë dhe të intensifikojnë kryerjen e atyre iniciativave që kanë një impakt më të ndjeshëm në arritjen e treguesve, sic mund të përmenden masat nën objektivët A1, A2, A4, A5, A9, A11 dhe objektivët B dhe C3.

Krahasuar me periudhën korrik - shtator 2020 të monitorimit, ka një ecuri të lehtë progresi, dhe kryesisht në masa dhe aktivitete të parashikuara për objektivat në qasjen parandaluese.

Shtimi i 5 autoritete të reja publike që kanë instaluar regjistrin elektronik të kërkesave dhe përgjigje, për periudhën raportuese korrik – shtator 2021 është një hap pozitiv në drejtim të objektivit A1.

Objektivi A3 ka një shkallë realizueshmërie më të mirë, me 1209 e-shërbime të shtuara dhe në përdorim deri në këtë periudhë të vitit 2021, duke realizuar kështu vlerën e synuar për vitin.

Objektivët A8 e A9 vijojnë në mënyrë progresive zbatimin e metodologjisë së vlerësimit të riskut të integritetit në varësitë e MD fillimisht (sipas planifikimit).

Është përmirësuar realizimi i objektivit C1, ku Ministria e Drejtësisë ka hartuar dhe publikuar për herë të parë një buletin periodik me një përmbledhje aktivitetesh të zhvilluara përgjatë çdo muaji.

Si përfundim, për këtë periudhë raportimi vijojnë të adresohen si sfidë kryesore në zbatimin e planit të veprimit, çështje si:

- fokusimi në ato elementë të posaçëm që kanë një ndikim direkt dhe thelbësor në arritjen e objektivave specifike;
- mungesa e raportimit financiar për të gjitha aktivitetet dhe masat në zbatim për këtë periudhë raportimi;
- mungesa e qasjes proaktive në ngritjen e grupeve të përbashkëta ndërinstitucionale për zbatimin e masave të parashikuara në planin e veprimit;
- kontributet e sjella nga institucionet janë në disa raste jo të plota dhe jo relevante me masën apo aktivitetin specifik në monitorim, për shkak të mungesës së eksperiencës apo njohurive konkrete në këtë proces;
- adresimi në kohën e duhur i problematikave që kanë sjellë si pasojë realizimin e ulët apo mosrealizimin e objektivave përkatës;

- përmirësimi i kapaciteteve teknike dhe njerëzore që kontribuojnë në arritjen e rezultateve të parashikuara;
- ndërgjegjësimi mbi punën e shtuar që duhet të kryejnë institucionet që rezultojnë me një realizueshmëri të ulët, sa i takon nivelit të arritjeve mbi objektivin, masën apo aktivitetin specifik, të cilët rriten me kalimin e kohës, sipas parashikimeve në Planin e Veprimit 2020-2023. Sjellim këtu si shembull vlerën e synuar për miratimin e planeve të integritetit në ministritë e linjës dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- mungesa e identifikimit të rregullt të hapave konkretë të rradhës;
- raportimet e përditësuara për progresin e bërë vetëm për periudhën e kërkuar të zbatimit të planit të veprimit;
- çështje të tjera që lidhen me mjedisin rregullativ të brendshëm dhe mjedisin e jashtëm,

faktorë këto që kanë patur ndikimin e tyre në ecurinë e deritanishme të zbatueshmërisë së masave dhe aktiviteteve të planifikuara në Planin e Veprimit.

Metodologjia e hartimit të raportit të monitorimit

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 114, dt. 04.09.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Drejtësisë”, është ngritur Sektori i Programeve në Fushën Antikorrupsion, pranë Drejtorisë së Programeve dhe Projekteve në Fushën Antikorrupsion, e cila është struktura përgjegjëse për procesin monitorues dhe për hartimin e Raporteve periodike të Monitorimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015 - 2023.

Drejtorja e Programeve dhe Projekteve në Fushën Antikorrupsion (DPPFA) kryen koordinimin me të gjitha institucionet përgjegjëse, si dhe më pas vijon me hartimin e raportit të monitorimit. Ky raport mbulon periudhën *1 korrik deri më 30 shtator 2021* dhe është hartuar mbi bazën e kontributit të dhënë nga të gjitha institucionet e përfshira në Planin e Veprimit 2020- 2023 të SNKK-së. Qëllimi është që të kemi informacion mbi arritjet e progresit dhe sfidat drejt përmbushjes së objektivave të strategjisë.

Monitorimi i Strategjisë ka konsistuar në dy faza kryesore:

1. Raportimi i institucioneve nëpërmjet pikave të kontaktit antikorrupsion, mbi zbatimin e masave për të cilat janë përgjegjëse; dhe
2. Raportimi dhe analiza mbi progresin nga struktura teknike në KKK mbi zbatimin e PV-së në tërësinë e tij.

Secili institucion ka raportuar mbi nivelin e zbatimit të çdo qëllimi politike, objektivit specifikë, masash të realizuara (mbi bazë aktivitetesh të kryera), buxhetin e parashikuar për periudhën raportuese, buxhetin e alokuar për periudhën e raportimit, problemet e hasura, hapat e mëtejshme dhe vlerësimin e progresit të strategjisë në tërësi. Me qëllim monitorimin e zbatimit të angazhimeve të ndërmarra, përta i përket realizimit të masave (aktiviteteve) procesi i monitorimit

është kryer për çdo qëllim politikash (qasje) të strategjisë, në përputhje me formatin (aneks) të përdorur për mbledhjen e kontributit të raportimit, sipas guidës metodologjike mbi strukturën e raporteve të monitorimit për dokumentet strategjike sektoriale dhe ndërsektoriale për agjendën e mirëqeverisjes.

Vlerësimi i progresit të zbatimit të SNKK për këtë periudhë raportimi është kryer nga DPPFA përmes analizës së të dhënave të përcjella nga institucionet raportuese duke iu përmbajtur metodës së analizës së parashikuar në Vendimin nr.290, datë 11.4.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Bazës të të Dhënave Shtetërore të Sistemit Informatik të Planifikimit të Integruar (SIPI/IPSIS)” dhe Urdhrit nr.157, datë 22.10.2018, të Kryeministrit, “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar”.

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 157, datë 22.10.2018 “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e Mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar”, janë krijuar 8 Grupe Tematike, të cilat janë pjesë e Grupit të Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP) për Mirëqeverisjen dhe Administrimin Publik. Konkretisht, për Ministrinë e Drejtësisë është ngritur Grupi Tematik Antikorrupsion (GTA).¹

GMIP do të sigurojë një strukturë të menaxhimit të nivelit të lartë, lidhur me:

- vendimmarrjen politike dhe menaxheriale të nivelit të lartë në planifikimin dhe monitorimin e reformave sektoriale, politikave dhe kuadrit strategjik;
- koordinimin e planifikimit, programimit dhe monitorimit për sektorët e përfshirë, nëpërmjet organizimit të dialogut të rregullt me partnerët për zhvillim;
- ofrimin e mbështetjes në kuadrin e procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian;
- dialogun qeveritar mbi politikat me partnerët për zhvillim, qeverisjen vendore, shoqërinë civile dhe sektorin privat, zbatimin e masave brenda fushës dhe sektorëve përkatës dhe promovimin dhe mbështetjen e iniciativave të koordinuara.

Në kontekstin e integritimit evropian, këto struktura do të luajnë rolin e Komitetit Sektorial Monitorues për projektet IPA, duke siguruar raportimin e monitorimit të fondeve IPA, sipas sektorëve.

Analiza e të dhënave është bërë në përputhje me aktet e sipërcituara dhe strukturës orientuese për monitorimin e strategjive dhe planeve të veprimit.

Së pari, është analizuar zbatimi i masave dhe të aktiviteteve (realizimi i produkteve) duke dhënë një rezultat sasior dhe cilësor të realizimit të tyre përkundrejt kryerjes së aktiviteteve respektive të lidhura me to.

¹ Këtë rol e luan Komiteti Koordinator për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit.

Së dyti, është analizuar realizimi i objektivave specifike përmes përlogaritjes së shkallës së realizueshmërisë së tyre.

Shkalla e realizimit të objektivit përkundrejt zbatimit të masave është kryer në bazë të 4 intervaleve të sistemit të performancës si në tabelën dhe kodin e ngjyrave më poshtë.

Kategoria	Niveli i Tolerancës	Pikët (110)
Dobët	Nga 0 deri në 30 për qind e masave të realizuara	30
Mjaftueshëm	Nga 31 në 50 për qind e masave të realizuara	20
Mirë	Nga 51 në 85 për qind e masave të realizuara	35
Shumë mirë	Nga 86 në 110 për qind e masave të realizuara	25
Tejkaluar	111 dhe më lart	N/A

Për përlogaritjen e realizimit të objektivëve specifike sipas arritjes së masave dhe aktiviteteve është përdorur formula si më poshtë²:

$$NR = \frac{\text{Masa 1 NR} + \text{Masa 2 NR}}{2 \text{ Masa}} \times 100\%$$

Niveli tjetër i analizës është ai sipas qëllimeve të politikës (qasjeve). Bazuar në të dhënat e realizueshmërisë për secilin nivel analitik (masa dhe objektiv specifik) është vlerësuar secili nga tre qëllimet e politikave (qasjeve): parandalimi, ndëshkimi dhe ndërgjegjësimi.

Një vlerësim më i përgjithshëm përmbledhës është kryer gjithashtu për realizimin e strategjisë në tërësi për këtë periudhë raportimi.

Ecuria e progresit në periudhën që monitorohet, klasifikohet në këto kategori³:

- **E zbatuar:** Institucionet kanë raportuar statusin “E zbatuar” për ato masa e aktivitete të cilat janë përmbyshur.

² Formula është marrë nga guida dhe udhëzuesi strukturor për monitorimin dhe vlerësimin e raporteve të monitorimit të dokumenteve strategjike, IPSIS dhe përshtatur për vlerësimi ne masave dhe aktivitete (subjekt i këtij raporti monitorimi).

³ Në këtë kolonë jepet statusi i realizimit të masës. Statusi mund të jetë: plotësisht i realizuar; pjesërisht i realizuar; ose i porealizuar. Masa "plotësisht i realizuar" është masa, objekti i të cilit është realizuar plotësisht, siç përcaktohet në planin e veprimit. Masa "pjesërisht i realizuar" është ajo masë që është realizuar në shkallën nga 51 deri në 90 për qind. Masa “i porealizuar” është ai i cili është realizuar në një shkallë nga 0 në 50 për qind. Për të treguar statusin përdoret statusi i shkruar dhe kodet e ngjyrave. Qeliza e masës plotësisht të realizuar theksohet me ngjyrë të gjelbër. Kolona e masës të realizuar pjesërisht theksohet me ngjyrë të verdhë. Kolona e masës të porealizuar theksohet me të kuqe.

- **Pjesërisht e zbatuar/Në proces:** Institucionet kanë raportuar statusin “Në proces” për ato masa e aktivitete, të cilat në periudhën e raportimit kanë pasur zbatim të pjesshëm dhe/apo që vijojnë të jenë në zbatueshmëri prej tyre.
- **E pazbatuar:** Të pazbatuara janë raportuar ato masa e aktivitete të cilat nuk kanë regjistruar zhvillim për periudhën raportuese si dhe gjithashtu ato masa e aktivitete për të cilat nuk është dhënë raportim nga institucionet përgjegjëse.

Në raportimet e sjella nga institucionet përgjegjëse sipas Planit të Veprimit 2020-2023, vihet re se disa masa/aktivitete të planifikuara për t’u zbatuar në tremujorin e katërt të vitit 2021, kanë filluar zbatimin e tyre në avancë. Sjellim këtu si shembull aktivitetin. Psh. A.4.1.1, A.4.1.2 dhe B.2.1.1.

Matrica e Riskut

Në këtë raport monitorimi është përfshirë edhe një vlerësim dhe identifikim i risqeve me qëllim identifikimin e hapave që do të duhen të ndiqen për tu adresuar në kuadër të implementimit të objektivëve të SNKK.

Vlerësimi i riskut është bërë në përputhje si me tabelën më poshtë:

Mundësia	E lartë	3	6	9	
	E mesme	2	5	8	
	E ulët	1	4	7	
		E ulët	E mesme	E lartë	
		Ndikimi			

Konsultimi publik

Në përputhje me kriteret ligjore për konsultimin publik, pas hartimit të draft raportit, Ministria e Drejtësisë e dërgoi dokumentin për konsultim pranë institucioneve raportuese dhe organizatave të shoqërisë civile, si dhe publikoi draftin në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, ku caktohet dhe një adresë elektronike për marrjen e komenteve, në faqen e internetit www.drejtësia.gov.al, në menu prioritete/strategjia ndërsektoriale/strategjia ndërsektoriale kundër korrupsionit⁴.

Drafti është dërguar për vlerësim paraprak edhe pranë Departamentit të Mirëqeverisjes dhe Zhvillimit në Kryeministri, në rolin e vlerësuesit të raportit të monitorimit.

Në përfundim të procesit konsultues, Ministria e Drejtësisë kreu reflektimin e komenteve/sugjerimeve relevante mbi draft raportin e monitorimit dhe vijoi me zhvillimin e një takimi të dedikuar, datë 14.12.2021, të diskutimit të analizës së kryer, gjetjeve të raportit, vlerësimit të qëllimeve të politikës në prezencë të të gjithë institucioneve zbatuese dhe raportuese të planit të veprimit.

Raporti i konsultimit publik të raportit të monitorimit është gjithashtu i publikuar në faqen e internetit të ministrisë, www.drejtësia.gov.al.

Në përfundim, sekretariati teknik pranë GT për antikorrupsionin (Sektori i programeve në fushën antikorrupsion) paraqet draftin për diskutim e miratim në mbledhjen e Komitetit Koordinator për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, 2015-2023. Pas miratimit të draft raportit të monitorimit, korrik - shtator 2021, paketa e plotë e raportit dërgohet në Sekretariatit e Përgjithshëm të Grupit të Menaxhimit të Integruar të Politikave për Mirëqeverisjen dhe Administrim Publik. Raporti i miratuar i monitorimit publikohet në faqen e internetit të www.drejtësia.gov.al.

PROGRESI I STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT

Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2023 ka si synim arritjen e objektivave madhorë të kësaj strategjie nëpërmjet realizimit të masave konkrete antikorrupsion, me qëllim zhvillimin e një shoqërie në të cilën ekziston një sistem i përgjegjshëm dhe efikas kundër korrupsionit, i cili është në gjendje për të përfituar rezultate të prekshme dhe të tregojë tendencë drejt eliminimit maksimal të kërcënimeve të korrupsionit, si dhe vullnetit për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin. Për të monitoruar ecurinë e SNKK 2015-2023, është hartuar raporti periodik i rradhës, në kuadër të zbatimit të Planit të Veprimit 2020– 2023, i cili mbulon periudhën *1 korrik deri më 30 shtator 2021*.

Masa dhe aktivitete të implementuara me sukses në periudhën përkatëse

⁴ Shiko me shumë: <https://www.drejtësia.gov.al/wp-content/uploads/2021/11/Draft-Raporti-i-monitorimit-SNKK-Korrik-Shtator-2021.pdf>,

Qëllimet e politikave (qasjet) dhe objektivat specifikë bëhen të realizueshëm nëpërmjet masave dhe aktiviteteve të parashikuara (produkte), të parashikuara për zbatim, nga institucionet përgjegjëse edhe bashkëpunëtorë të Strategjisë dhe të Planit të Veprimit.

SNKK ka **tre qëllime kryesore politikash** (qasje) përmes të cilave synon të përmbushë vizionin e saj dhe 18 objektiva specifikë.

Duke aplikuar të njëjtën formulë⁵ të vlerësimit të shkallës së realizimit të objektivave – duke mbledhur realizueshmërinë në përqindjes të qëllimeve të politikës dhe pjesuar me numrin e tyre – realizueshmëria e qëllimit strategjik ndër-institucional kundër korrupsionit është 62.85%.

Qasja Parandaluese (A)	81.96 %
Qasja Ndëshkuese (B)	49.77 %
Qasja Ndërgjegjësuere (C)	56.83 %

Vërehet se të treja qasjet paraqesin një trend më pozitiv kundrejt periudhës së mëparshme të raportimit. Krahasuar me monitorimin e kryer për 6M1 2021, Qasja Parandaluese (A) shfaq një trend rritës me 16.82% më shumë, Qasja Ndëshkuese (B) shfaq një trend rritës me 14.5% më shumë dhe Qasja Ndërgjegjësuere (C) shfaq një trend rritës me 33.33% më shumë.

Konkretisht sipas 18 objektivave specifikë, niveli i realizueshmërisë sipas masave dhe aktiviteteve për zbatim për periudhën e monitorimit, është si më poshtë:

Qasja A	Realizueshmëria
A.1	83.33%
A.2.	83.33%
A.3	100%
A.4	80%
A.5	100%
A.6	70%
A.7	87.5%
A.8	62.5%
A.9	85%
A.10	100%

Qasja C	Realizueshmëria
C.1	62.5%
C.2	83 %
C.3	25%

⁵ Shiko footnote 3.

A.11	50%
------	-----

Qasja B	Realizueshmëria
B.1	70%
B.2	41.6%
B.3	50%
B.4	37.5%


Ndërsa duke marrë në konsideratë nivelin e realizueshmërisë (në përqindje) të objektivave në raportin 6M1 2021 përkundrejt realizueshmërisë së masave dhe aktiviteteve për periudhën në monitorim, korrik - shtator 2021, kemi trend rritës në masat e 12 objektivave, konkretisht A.1, A.4, A.5, A.6, A.8, A.9, A.10, A.11, B.1, B.2, B.3, C.2 dhe trend zbritës në masat e 5 objektivave, konkretisht A.2, A.3, B.4, C1, C.3.

Plani i Veprimit 2020 – 2023, për vitin 2021 parashikon zbatimin e 118 aktivitete e 67 masa, të shpërndara përkatësisht në 65 aktivitete e 36 masa për Qëllimin e Politikës I (qasjen parandaluese A), 32 aktivitete e 22 masa për Qëllimin e Politikës II (qasjen ndëshkuese B) dhe 21 aktivitete e 9 masa për Qëllimin e Politikës III (qasjen ndërgjegjësuese C).

Për këtë periudhë monitorimi, *korrik - shtator 2021*, rezulton se janë parashikuar për zbatim 107 aktivitete dhe 59 masa, nga të cilat: 57 aktivitete e 30 masa janë pjesë e Qasjes A (Qëllimi i Politikës I), 29 aktivitete dhe 20 masa janë pjesë e Qasjes B (Qëllimi i Politikës II) dhe 21 aktivitete dhe 9 masa janë pjesë e Qasjes C (Qëllimi i Politikës III).


Qëllimet e Politikës (Qasja)	Aktivitetet dhe Masat	Aktivitete dhe Masa, korrik – shtator 2021		
		Aktivitete dhe Masa të parashikuara për vitin 2021	Aktivitete dhe Masa të parashikuara për 3M3 2021	Aktivitete dhe Masa të parashikuara për 3M4 2021
Parandaluese	Masa	36	30	1
	Aktivitete	65	57	9

Ndëshkuese	Masa	22	20	0
	Aktivitete	32	29	0
Ndërgjegjësuere	Masa	9	9	0
	Aktivitete	21	21	1
Total	Masa	67	59	1
	Aktivitete	118	107	10



Për periudhën raportuese korrik - shtator 2021, janë në monitorim 59 masa dhe 107 aktivitete në total. Për gjithë vitin 2021, totali i aktiviteteve është 118, ndërsa i masave është 67.

Statusi i masave dhe aktiviteteve që kanë realizuar qëllimet e politikave (qasjet):



Progresi total i arritur në kuadër të përmbushjes së tre qëllimeve të politikës (qasjeve) të strategjisë lidhur me statusin e zbatimit të aktiviteteve dhe masave është si më poshtë:

- 29 masa e 65 aktivitete të realizuara;
- 22 masa e 21 aktivitete ende në proces zbatimi;
- 8 masa e 21 aktivitete të pazbatuara.

Përsa më sipër, nga **29 masa e 65 aktivitete të realizuara** për tremujorin e tretë të vitit 2021, konkretisht 18 masa/40 aktivitete i përkasin qasjes parandaluese (A), 7 masa/13 aktivitete i përkasin qasjes ndëshkuese (B), si dhe 4 masa/12 aktivitete i përkasin qasjes ndërgjegjësuere (C).


Nga **22 masa e 21 aktivitete të cilat janë ende në proces zbatimi** për tremujorin e parë të vitit 2021, konkretisht 9 masa/10 aktivitete i përkasin qasjes parandaluese (A), 9 masa/8 aktivitete i përkasin qasjes ndëshkuese (B), si dhe 4 masa/3 aktivitete i përkasin qasjes ndërgjegjësuere (C).

Nga **8 masa e 21 aktivitete të parealizuar** për tremujorin e parë të vitit 2021, konkretisht 2 masa/5 aktivitete i përkasin qasjes parandaluese (A), 5 masa/10 aktivitete i përkasin qasjes ndëshkuese (B), si dhe 1 masë/6 aktivitete i përkasin qasjes ndërgjegjësuere (C).

Statusi i aktiviteteve që kanë realizuar qëllimet e politikave (qasjet):

Nga totali prej 107 aktiviteteve të parashikuara për zbatim në *korrik – shtator 2021*, 57 prej tyre i përkasin Qasjes A, 29 aktivitete i përkasin Qasjes B, si dhe 21 aktivitete Qasjes C.

Statusi i aktiviteteve në Planin e Veprimit 2020 - 2023, për periudhën korrik–shtator 2021				
Progresi i aktiviteteve	Qasja A (Parandaluese)	Qasja B (Ndëshkuese)	Qasja C (Ndërgjegjësuere)	Totali i Qasjeve
Zbatuar	40	13	12	65
Në proces	10	8	3	21
Pazbatuar	5	10	6	21
Totali	55	31	21	107



Rezulton se nga 107 aktivitete të parashikuara për periudhën *korrik – shtator 2021*, statusi i tyre për të 3 qasjet është raportuar si më poshtë:


- 65 aktivitete të zbatuara;
- 21 aktivitete janë ende në proces zbatimi;

- 21 aktivitete të pazbatuara (mungon raportimi) nga institucioni përgjegjës (nga ku mund të përmendim A.6.1.1, A.6.1.2, A.7.3.2, A.7.3.4, A.8.7.1, B.1.3.1, B.2.3.1, B.2.3.3, B.2.3.4, B.2.4.1, B.2.4.2, B.2.5.1, B.4.1.2, B.4.3.1, B.4.4.1, C.2.2.2, C.3.1.6, C.3.2.1, C.3.2.2, C.3.2.3)

Statusi i masave që kanë realizuar qëllimet e politikave (qasjet):

Nga totali prej 59 masash të parashikuara për zbatim në korrik – shtator 2021, 29 prej tyre i përkasin Qasjes A, 22 masa i përkasin Qasjes B, si dhe 8 masa Qasjes C.

Statusi i masave në Planin e Veprimit 2020 - 2023 për periudhën korrik–shtator 2021				
Progresi i masave	Qasja A (Parandaluese)	Qasja B (Ndëshkuese)	Qasja C (Ndërgjegjësuere)	Totali i Qasjeve
Zbatuar	18	7	4	29
Në proces	9	9	4	22
Pazbatuar	2	5	1	8
Totali	29	21	9	59



Rezulton se nga 59 masa të parashikuara për periudhën korrik – shtator 2021, statusi i tyre për të 3 qëllimet e politikës (qasjet) është raportuar si më poshtë:

- 29 masa të zbatuara;
- 22 masa janë ende në proces zbatimi;
- 8 masa të pazbatuara nga institucioni përgjegjës (nga ku mund të përmendim A.6.1, A.8.7, B.1.3, B.2.4, B.2.5, B.4.3, B.4.4, C.3.2).

Gjithashtu vlerësohet se masa A.4.1 ka filluar të zbatohet para afatit të përcaktuar në planin e Veprimit 2020-2023, mungon raportimi për masën B.1.3 si dhe është parashikuar për zbatim në tremujorin e fundit të vitit 2021, masa A.5.5.

Vlerësimi i arritjeve kryesore duke përdorur masat dhe aktivitetet:

Mbështetur në informacionin mbi raportimin dhe vlerësimin e aktiviteteve dhe masave të realizuara, realizimi i objektivëve për *korrik - shtator 2021*, është si më poshtë.

Dobët - 1 objektiv (objektivi: C.3)

Mjaftueshëm - 4 objektiva (A.11, B.2, B.3, B.4)

Mirë - 9 objektiva (objektivi: A.1, A.2, A.4, A.6, A.8, A.9, B.1, C.1, C.2)

Shumë mirë - 4 objektiva (objektivi: A.3, A.5, A.7, A.10)

Tejkaluar – N/A objektiva.

Histori suksesi (përmes masave prioritare)

Ecuria e arritur në kuadër të përmbushjes së aktiviteteve dhe masave të parashikuara, për periudhën e monitorimit, *korrik – shtator 2021*, në zbatim të Planit të Veprimit 2020-2023, të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015- 2023, është si më poshtë vijon:

- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka realizuar monitorimin e programeve të transparencës së ¾ të Autoriteteve Qendrore dhe njësisve të vetëqeverisjes vendore. Në total janë monitoruar 235 nga 317 autoritete publike dhe 46 nga 61 Njesi të Vetëqeverisjes Vendore. Gjithashtu vijon instalimi i regjistrit elektronik të kërkesë-ankesave në zbatim të së drejtës së informimit.- (objektivi A1)
- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit ofron 1209 shërbime elektronike. Portali e-Albania u ka shërbyer 2 148 407 qytetarëve, 160 575 bizneseve, me një numër total prej 2.3 milionë regjistrimesh. – (objektivi A3)
- Sektori për Hetimin e Korrupsionit, në Drejtorinë për Krimet Ekonomike e Financiare në Policinë e Shtetit ka evidentuar 799 vepra penale dhe janë zbuluar 761 prej tyre, 7 prej të cilave janë të vjetra , ose në 95.24% e tyre. Janë proceduar 1125 autorë, nga të cilët 204 autorë

- të arrestuar dhe ndaluar, 892 proceduar në gjendje të lire dhe 29 janë shpallur në kërkim.- (objektivi A4)
- ILDKPKI ka vazhduar procesin e koordinimit dhe mbështetjes me qëllim finalizimin e angazhimeve të marra në kuadër të ngritjes së sistemit elektronik të deklarimit të interesave private. – (objektivi A5)
 - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka ndryshuar e miratuar formatin e raportimit të monitoruesve dhe audituesve në përputhje me ndryshimet ligjore, janë përditësuar/ndryshuar/shtuar udhëzimet në lidhje me raportimin financiar të monitoruesve; është vijuar me forcimin e kapaciteteve (trajnime) të 64 monitorues (32 femra dhe 32 meshkuj) dhe 19 auditues ligjor. - (objektivi A6).
 - MFE ka vijuar me realizimin e 19 vlerësime të jashtme të cilësisë në njësitë e auditit të brendshëm që funksionojnë në njësitë publike; ka vijuar me zhvillimin e takimeve me përfaqësues të drejtorisë së auditit, të institucioneve qendrore si dhe ka zhvilluar 4 trajnime me inspektorët financiarë publik mbi rastet e keqmenaxhimit, shpërdorimit të detyrës. - (objektivi A7).
 - Institucionet e varësisë së Ministrisë së Drejtësisë vazhdojnë procesin e vlerësimit të riskut të integritetit, në përputhje me dokumentin “Metodologjia e Vlerësimit të Riskut të Integritetit në Institucionet Qendrore” nën koordinimin e Ministrisë së Drejtësisë (1 takim i dedikuar në grup informuese/ndërgjegjësuere me përfaqësues e punonjës së varësive të MD); - (objektivët A8 e A9);
 - Është kryer mbledhja e të dhënave dhe administrimi i informacioneve statistikore për veprimtarinë e institucioneve ligjzbatuese kundër korrupsionit dhe asetëve të konfiskuara të dhëna statistikore të harmonizuara, nga institucione si; Policia e Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme, SPAK, AAPSK, gjykatat, të dhëna që do të jenë pjesë e Vjetarit Statistikor 2021; të dhënat statistikore janë mbledhur e harmonizuar edhe për krimin e organizuar. - (objektivi A10).
 - SPAK ka regjistruar gjithsej 23 procedime me 15 persona në hetim; dhe ka dërguar për gjykim 2 procedime me 12 të pandehur. Është bërë kërkesë për pushim për 1 procedim me 2 të pandehur. - (objektivi B1).
 - Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje raporton periodikisht mbi denoncimet e qytetarëve dhe bizneseve, çdo javë nëpërmjet të dhënave të detajuara të paraqitura në raport për çdo ministër dhe Kryeministrin; janë regjistruar 4448 çështje, kërkesa, ankesa, nga të cilat 2 699 i përkasin autoriteteve në nivel qendror, 943 në nivel vendor dhe 806 janë për çështje biznesi; janë dhënë 18 masa ndëshkimore nga hetimet administrative të institucioneve përgjegjëse për mosdhënien në kohë të së drejtës të qytetarëve. Në faqet zyrtare të Platformës së Bashkëqeverisjes publikohen minimalisht 2 postime në javë, me anë të të cilave, promovohet puna e kryer nëpërmjet rasteve të suksesit ose raporteve si dhe orientohen qytetarët se si mund të aplikojnë në platformë – (Objektivi C2).

EKZEKUTIMI I BUXHETIT

Sipas SNKK, financimi i Planit të Veprimit realizohet nga dy burime kryesore: buxheti i shtetit dhe mbështetja financiare e partnerëve ndërkombëtarë.

Në kuadër të monitorimit të zbatimit të aktiviteteve e masave të Planit të Veprimit 2020 - 2023, edhe për këtë periudhë institucioneve përgjegjëse u është kërkuar të raportojnë mbi buxhetin e përdorur në bazë të performancës së kryer.

Buxheti i përdorur i sjellë nga institucionet kontribuese dhe burimi konkret i financimit sipas objektivëve është si vijon:

A1: 18.674.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

A2: 7.276.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

A4: 3.598.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

A5: 19.400.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

A7: 9.212.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

A8: 195.000.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

A9: 89.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

A10: 89.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

B1: 55.244.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit dhe 7.000.000 lekë mbuluar nga donator.

B3: 28.455.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

C1: 29.012.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

Objektivët A3, A.11, C.2 dhe C.3 nuk kanë raportuar kosto të përdorur (0).

Objektivi A6 ka raportuar kosto për çdo masë dhe aktivitet por nuk ka kryer shpenzime në këtë periudhë monitorimi.

Buxheti i ndarë sipas qëllimeve të politikës/Qasjeve A-B-C, është:

Qëllimi i politikës I (qasja parandaluese - A)

253.338.000 lekë mbuluar nga buxheti i shtetit

Qëllimi i politikës II (qasja ndëshkuese - B)

83.699.000 mbuluar nga buxheti i shtetit.

7.000.000 mbuluar nga donatorë

Qëllimi i politikës III (qasja ndërgjegjësuere - C)

29.012.000 lekë mbuluar nga buxheti i shtetit

Nga analiza për aktivitetet dhe masat e raportuara në mënyrë progresive, për periudhën korrik – shtator 2021, buxheti i planifikuar për këtë periudhë monitorimi është 1.532.204.000 lekë. Ndërkohë totali i buxhetit të përdorur për këtë vit është:

- Financimi për këtë periudhë monitorimi nga buxheti i shtetit është në shumën 366,049,000 lekë.
- Financimi nga donatorët është në shumën 7,000,000 lekë.

Shumë aktivitete të kryera gjatë kësaj periudhe raportimi janë në “kosto administrative”, të mundësuar dhe mbuluara nga kapacitetet njerëzore dhe financiare të institucioneve zbatuese, duke mos paraqitur kosto shtesë për institucionet zbatuese, në përputhje edhe me parashikimin e bërë në Planin e Veprimit. Kështu në total, janë 12 aktivitete që raportohen të jenë kryer me “kosto administrative” dhe 10 aktivitete me 0 (zero) kosto.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Mbështetur në rezultatet e monitorimit të kryer, rezulton se për periudhën *1 korrik – 30 shtator 2021*, fushat që kanë treguar performancë por edhe shoqëruar nga problematika janë aktivitete dhe masa të shpërndara në të gjithë objektivet specifike në të tre qëllimet e politikës (qasjet) e SNKK, parandalim (A) – ndëshkim (B) – ndërgjegjësim (C).

Në vijim të analizës terësore të kontributeve të ardhura nga institucionet raportuese, vihet re një përmirësim i ndjeshëm në realizueshmërinë e qasjes A, por nga ana tjetër mbetet shqetësues niveli i realizimit të përgjithshëm të qasjeve B. Një vëmendje e posaçme duhet t’i kushtohet përmirësimit të objektivit C3, i cili është i vetmi objektivi me një realizim të dobët gjatë kësaj periudhe raportuese. Në vijim gjenden disa rekomandime dhe vlerësime konkrete për adresimin e problematikave të konstatuara.

Rekomandime

Në përfundim të këtij raporti, rekomandimet për vijueshmërinë e zbatimit të planit të veprimit janë:

- Të ndiqen me përparësi ato masa që kanë një nivel të dobët realizueshmërie përgjatë gjithë vitit 2021, konstatuar kjo edhe në dy raportet e mëparshme të monitorimit.
- Të përmirësohet performanca e aktivitetit të institucioneve që raportojnë aktivitete e masa në proces zbatimi;
- Të vijojë të kryhet krahasimi i numrave me të njëjtën periudhë raportuese të vitit të kaluar ose 2 viteve të fundit, sidomos kur kemi të bëjmë me të dhëna statistikore, të shprehura me numra konkretë.

- Të raportohet në përgjigje të kërkesës së raportimit nga pikat e kontaktit antikorrupsion, sepse mosraportimi ndikon në kryerjen e një analizë reale dhe të saktë të zbatueshmërisë së Planit të Veprimit 2020-2023;
- Të raportohet informacioni mbi buxhetin e përdorur për masat e planit të veprimit dhe për aq sa është e mundur buxheti i shpenzuar për realizimin e aktiviteteve të mbuluara nga donatorët;
- Të evidentohen pengesat e mundshme në kuadër të zbatimit të masave dhe aktiviteteve të parashikuara në Planin e Veprimit 2020-2023, (psh mungesa e burimeve njerëzore; mosparashikimi i elementëve të caktuar në kohën e parashikimit të masave në planin e veprimit; mungesa e buxhetit për disa aktivitete; vërshtirësia në trajnimin e stafit; vërshtirësi në koordinimin mes institucioneve etj),
- Të vijojë raportimi në përputhje me metodologjinë *SIFI/IPSIS* për periudhën në vijim.
- Të shmanget raportimi i njëjtë për disa aktivitete të ndryshme, duke sjellë si shembull aktivitetin A.2.1.2 me A.2.2.2 dhe A.2.3.2. apo B.1.6.1. me B.4.2.1.
- Të vijojë puna me të njëjtin ritëm për instalimin e regjistrit qendror të kërkesave dhe përgjigjeve nga autoritetet publike si dhe të vijojë monitorimi i kryer nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në mënyrë periodike për të parë ecurinë e këtij procesi deri në fund të vitit 2021.
- të fillojë kryerja e aktiviteteve dhe masave për 1 objektiv të strategjisë, që rezulton në nivelin e zbatimit dobët (*nga 0 deri në 30 për qind e masave të realizuara*), Dobët – objekti C.3.
- Të përmirësohet performanca e kryerjes së aktiviteteve dhe masave për 4 objektive të strategjisë me synim arritjen e vlerës vjetore të treguesit të performancës, që rezultojnë në nivelin e zbatimit mjaftueshëm (*nga 31 në 50 për qind e masave të realizuara*), përkatësisht për objektivet A11, B.2, B.3, B.4.
- Detajimi i fushave konkrete sipas përgjegjësisë shtetërore të organit publik, për të cilin janë kryer trajnimet përkatëse të punonjësve në funksion të rritjes së kapaciteteve. Sjellim si shembull aktivitetin A.6.4.2.
- Të lidhet një marrevëveshje bashkëpunimi PSH-AMSHC në kuadër të forcimit të bashkëpunimit të PSH me OSHC-të, për gjenerimin e raporteve vlerësuese mbi hetimin e rasteve të korrupsionit, për të matur nivelin e riskut në prirjet kundër korrupsionit dhe të realizohen tryeza të përbashkëta.
- Të vijojë trajnimi dhe zhvillimi i kapaciteteve të ngritura të strukturave të specializuara që merren me hetimin e krimit të korrupsionit në PSH.
- Të miratohet draft udhëzimi i Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve në lidhje me raportimin vjetor të partive, si model standard, në përputhje me ndryshimet e reformës legjislative.
- AMVV duhet të marrë masat e nevojshme dhe konkrete për të inkurajuar njësitë e vetë qeverisjes vendore të përcaktojnë një buxhet specifik për implementimin e politikave vendore antikorrupsion, në përputhje me Strategjinë Antikorrupsion.

Vlerësimi i sfidave, boshllëqeve dhe joefikasitetit

Me qëllim forcimin e ndërgjegjësimit në luftën e përbashkët kundër korrupsionit, dhe në zbatim të aktiviteteve konkrete të paplotësuara, AMSHC do duhet të formatojë disa evente fizike apo virtuale, midis PSh dhe OSHC që operojnë në fusha si arsimit/shëndetësia/tatimet & doganat/e pronat, brenda rregullave që përcaktojnë protokollet e sigurisë të pandemisë.

Nevojitet forcimi i bashkëpunimit ndërmjet PSH dhe agjencive të tjera ligjzbatuese me fokus hetimin e korrupsionit, nëpërmjet takimeve të punës dhe hartimit të një kalendari fillestar të dedikuar ndaj këtyre takimeve.

Një sfidë e rëndësishme mbetet përmirësimi i kuadrit rregullator të raportimit financiar të partive politike. Në këtë aspekt duhet të rriten përpjekjet e përbashkëta për të miratuar modelin standart, në përputhje me ndryshimet e reformës legjislativë dhe të kryhen seanca trajnimit për modelin e raportimit financiar me grupt e interesit.

Duke e konsideruar si një praktikë shumë të mirë krahasimin e situatës aktuale me të njëjtën periudhë raportuese të vitit të kaluar, sugjerohet gjithashtu që Prokuroria e Përgjithshme të sjellë shifra që përputhen me formatin e raportimit të aneksit të këtij raporti.

Vlerësimi i riskut duke përdorur masat dhe aktivitetet

Në këtë raport monitorimi, *korrik - shtator 2021*, është kryer edhe një vlerësim i riskut për çdo objektiv në përputhje me nivelin e realizueshmërisë së tij.

Ndër risqet që u evidentuan mund të përmendim kapacitetet financiare, administrative, teknike, mjedisin rregullator dhe faktorë të tjerë të jashtëm. Mbetet gjithashtu një çështje prioritare bashkëpunimi efektiv i institucioneve raportuese në eliminimin e faktorëve të riskut dhe rritjen e nivelit të realizueshmërisë mbi objektiva, masa dhe aktivitete konkrete.

Objektivi A4 ka gjithashtu një nivel të lartë risku që lidhet kryesisht me proceset dhe sistemin. Policia e Shtetit nuk ka krijuar ende sistemin e të dhënave të ndara për rastet e hetimit të korrupsionit për të evidentuar veçmas hetimet për korrupsion të iniciuara përmes denoncimeve të qytetarëve.

Objektivi A11 vazhdon të ketë riskun e realizimit të lartë për shkak të rreziqeve të lidhura me mjedisin e brendshëm që lidhen me komunikimin dhe informimin, me çështje të tjera që lidhen me mjedisin rregullativ.

Është i nevojshëm raportimi i rasteve specifike nga Prokuroria e Përgjithshme dhe Prokuroria e Posaçme vetëm për ato dispozita të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, të parashikuara shprehimisht si aktivitete në Planin e Veprimit 2020-2023.

Në përfundim, të gjitha institucionet zbatuese të këtij plani veprimi, duhet të marrin në konsideratë këtë analizë dhe të shtojnë përpjekjet për zbatimin e masave dhe aktiviteteve duke pasur si prioritet arritjen e vlerave të treguesve të performancës për të arritur qëllimin e objektivëve specifike.

Hapat e rradhës

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën *korrik-shtator 2021*, të gjetjeve që ky raport na ofron, të të dhënave analitike që institucionet kanë raportuar dhe të analizës së kryer, adresohen të ndërmerren këto hapa në vijim:

A1: Rritja e transparencës në veprimtarinë shtetërore dhe përmirësimi i aksesit të qytetarëve në informacion:

Të vijojë monitorimi edhe në pjesën tjetër të autoriteteve qendrore dhe në Njësitë e tjera të Vetëqeverisjes Vendore si dhe të shtohet numri i autoriteteve publike që përdorin regjistrin elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve.

A.2 Rritja e transparencës në planifikim, menaxhim dhe kontrollin e fondeve publike

Agjencia e Prokurimit Publik duhet të specifikojë fushat e së drejtës në të cilat janë kryer trajnime apo vizita studimore me qëllim forcimin e kapaciteteve të punonjësve në lidhje me monitorimin e zbatimit të kontratës. Ajo gjithashtu duhet të përcaktojë hapat konkretë që ka ndjekur brenda kësaj periudhe raportimi, për hartimin e një rekomandimi, drejtuar autoriteteve/enteve kontraktore, me qëllim argumentimin më të plotë dhe më të thelluar në procesverbal, të kritereve të veçanta të kualifikimit dhe të specifikimeve teknike, parashikuar sipas aktivitetit A.2.3.1.

A.4 Përmirësimi i trajtimit të denoncimeve ndaj korrupsionit:

Të vijojë funksionimi me kapacitet të plotë i njësisë hetimore për krimin ekonomik e financiar të ngritur rishtazi, në Drejtorinë Qendrore Hetimore, brenda Departamentit të Policisë Kriminale në marrjen dhe trajtimin e duhur të veprave penale të korrupsionit dhe të plotësohet njësia hetimore e ngritur për krimin ekonomik e financiar në Drejtorinë Qendrore Hetimore, brenda Departamentit të Policisë Kriminale, me oficerët në organikë.

A.5 Forcimi i regjimit të deklarimit dhe kontrollit të pasurive të zyrtarëve publikë dhe rasteve të konfliktit të interesave:

Të vazhdojë zbatimi i kontratës “Shërbimi i Mirëmbajtjes së Sistemit të Deklarimit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit EACIDS” si dhe të merren masat e nevojshme për zbatimin në kohë të aktiviteteve të parashikuara për tremujorin e fundit të vitit 2021.

A.6 Forcimi i regjimit të kontrolleve mbi financimin e partive politike:

KQZ duhet të miratojë modelin standard për raportimin financiar për vitin kalendarik të partive politike, në përputhje me ndryshimet e reformës legislative.

A8: Përdorimi sistematik i mekanizmit të evidentimit të hapësirave për korrupsion:

Të vijojë procesi i vlerësimit të riskut të integritetit në të gjithë institucionet e varësisë së Ministrisë së Drejtësisë.

A9: Forcimi i integritetit të nëpunësve publik:

Të vijojë procesi i hartimit të planeve të integritetit në të gjithë institucionet e varësisë së Ministrisë së Drejtësisë dhe institucionet që e kanë hartuar dhe miratuar, duhet të fillojnë punën për zbatimin e tij.

A.11 Adaptimi i politikave antikorruption në nivelin e qeverisjes vendore:

Të ndiqen me prioritet masat e parashikuara dhe të vazhdojë nxitja që njësitë e vetëqeverisjes vendore të miratojnë një buxhet specifik për implementimin e Planit të Integritetit.

B1: Përmirësimi i efikasitetit dhe efektivitetit të hetimeve penale kundër korrupsionit:

Të forcohen dhe përmirësohen komunikimi, informimi dhe bashkëpunimi ndërinsitucional midis organeve ligjzbatuese, dhe të forcohen kapacitetet administrative respektive.

B.3. Rishikimi i kuadrit ligjor për ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe financiar:

Të vijojë zbatueshmëria e masave dhe aktiviteteve me qëllim ngritjen e ZRA në afatet e parashikuara, brenda afatit të ri të përcaktuar.

B.4. Përmirësimi i bashkëpunimit gjyqësor dhe policor ndërkombëtar në luftën kundër korrupsionit:

Të vijohet me kryerjen e trajnimeve të përbashkëta, forcimin e kapaciteteve profesionale dhe rritjen e bashkëpunimit me institucionet homologe ndërkombëtare si dhe me ngritjen e skuadrave të përbashkëta hetimore për hetimin e korrupsionit.

C2: Nxitja e publikut për të përdorur aktivisht mekanizmat për denoncimin dhe parandalimin e korrupsionit:

Platforma e bashkëqeverisjes duhet të krijojë mundësinë e dërgimit të rasteve të denoncimit të korrupsionit pranë Policisë së Shtetit.

C.3. Inkurajimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile:

Të sigurohet mbështetja financiare për ecurinë e masave dhe aktivitetëve të parashikuara në planin e veprimit dhe të sigurohet më shumë prezencë e organizatave të shoqërisë civile në hartimin e programeve antikorrupsion

